



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

**KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI PËR ANGAZHIMIN SI AUDITUES LIGJOR
OSE SHOQËRI AUDITUESE PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE
FINANCIARE TË BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE**

Bordi i Mbikëqyrjes Publike në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786 datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, njofton të gjithë të interesuarit të paraqesin kërkesën e tyre për t’u angazhuar si auditues ligjor ose shoqëri audituese për auditimin e pasqyrave financiare pranë BMP.

1. Audituesi Ligjor/ Shoqëria e auditimit duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara si më poshtë vijon:
 - a) Të jetë i regjistruar në regjistrin publik me jo më pak se dy auditues ligjorë;
 - b) Të mos kenë konflikt interesi me anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike apo me anëtarët e komisioneve që emërohen nga BMP sipas ligjit 10091/2009, i ndryshuar dhe kërkesave përkatëse të Kodit të Etikës;
 - c) Të mos kenë qenë objekt vlerësimi nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike në përfundim të kontrollit për sigurimin e cilësisë të paktën 1(një) vit para, si edhe të mos jetë objekt i vlerësimit të paktën 1 (një) vit pas përfundimit të angazhimit;
 - d) Të mos kenë qenë subjekt i parashikimeve të nenit 55 të ligjit të auditimit, i ndryshuar;
 - e) Shoqëria e auditimit duhet të ketë si pjesë të brendshme të strukturës së shoqërisë, burimet njerëzore me kompetencat e duhura profesionale për të kryer auditimin ligjor, ku ekipi i auditimit (pa përfshirë ortakun kryesor të auditimit) të ketë minimumi dy anëtarë me përvojë në mbikëqyrjen dhe kryerjen e angazhimeve të auditimeve ligjore;
 - f) “Ortaku kryesor i auditimit” ose të punësuarit e shoqërisë audituese me titull profesional “auditues ligjor”, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - i. Të paktën 3 (tre) vjet përvojë në fushën e auditimit ligjor të enteve publike rregullatore;
 - ii. Të mos kenë konflikt interesi me anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike, sipas përcaktimeve të Ligjit 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar dhe kërkesave përkatëse të Kodit të Etikës dhe ligjeve të fushës.
2. Dokumentacioni që duhet të paraqesin të interesuarit është:
 - a) Kërkesë më shkrim për shprehje interesi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- b) Vërtetim i regjistrimit në regjistrin publik të audituesve ligjorë me jo më pak se dy auditues ligjorë aktivë;
- c) Deklaratë mbi konfliktin e interesit sipas kërkesave të Ligjit nr. 10091/2009, i ndryshuar, dhe Kodit të Etikës:
 - i. E nënshkruar nga audituesi ligjor/ortaku kryesor i auditimit dhe nga të gjithë anëtarët e ekipit të auditimit, që vërteton se nuk ekziston konflikt interesi me:
 - Anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP)
 - Anëtarët e komisioneve të emëruara nga BMP
- d) Deklaratë mbi vlerësimet e mëparshme nga BMP, që konfirmon se subjekti nuk ka qenë objekt vlerësimi nga BMP në përfundim të kontrollit për sigurimin e cilësisë gjatë 2 viteve të fundit;
- e) Vërtetim që konfirmon se audituesi ligjor/shoqëria e auditimit nuk ka qenë subjekt i masave apo kufizimeve të parashikuara nga neni 55 i ligjit të auditimit, i ndryshuar.
- f) Përshkrimi i strukturës së brendshme së audituesit ligjor / shoqërisë së auditimit, duke treguar burimet njerëzore me kompetencat profesionale të nevojshme.
- g) Lista e ekipit të auditimit (pa përfshirë ortakun kryesor të auditimit) me të paktën dy anëtarë me përvojë në mbikëqyrjen dhe kryerjen e auditimeve ligjore.
- h) CV me kualifikimet dhe përvojën e “Ortakut Kryesor të Auditimit” dhe/ose audituesve ligjorë të shoqërisë që vërtetojnë:
 - Të paktën 3 vite përvojë në auditimin ligjor të enteve publike rregullatore.
 - Mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e BMP, sipas ligjit dhe Kodit të Etikës.
- i) Dokumente apo informacione shtesë të kërkuara nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesa dhe dokumentacioni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mësipërm deri në datën 26.08.2025, elektronikisht në adresën e emailit (info@bmp.al) ose pranë zyrave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, në adresën Rr: Ismail Qemali, Nd. 24, H. 4, Kati 5, Ap. 24, Tiranë.

Duke ju falënderuar!

Bordi i Mbikëqyrjes Publike